

VENDIM
Nr. 62, datë 14.12.2015

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR PROGRAMIN E
NXITJES SË PUNËSIMIT TË TË RINJVE, QË KANË FITUAR STATUSIN E
JETIMIT”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Znj. Anduena Dedja anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 14.12.2015, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, mori në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.

I. Procedura

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me shkresën nr. 6187, datë 2.12.2015, ka njoftuar pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore, ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftimin e planit të ndihmës para vënies në zbatim, në përputhje me nenet 20 dhe 21, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe nenit 5 e vijues, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””.

II. Përshkrimi i masës

3. Baza ligjore për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”, është:

a) Ligji nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se:

Neni 4

“1. Politikat shtetërore të punësimit përfshijnë si masat aktive për nxitjen e punësimit, ashtu edhe sigurimin e mbështetjes me të ardhura.

5. Politikat shtetërore të punësimit vendosen nga Këshilli i Ministrave dhe zbatohen nga ministria.”

Neni 8

“Mbajtja e vendeve ekzistuese dhe krijimi i vendeve të reja të punës:

1. Shteti mbështet punëdhënësit që krijojnë dhe mbajnë vende të reja pune dhe punësojnë në to kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit. Mbështetja shtetërore realizohet nëpërmjet:

a) subvencionimit, në përqindje të caktuar, të kostove për sigurimet e detyrueshme dhe të pagës;

b) subvencionimit apo kreditimit për pajisjen e vendit të punës. Punësimi për personat me arsim universitar dhe nga grupe të veçanta nxitet me përparësi.”

b) Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, i ndryshuar, neni 12 i të cilit parashikon se: *“Punësimi i jetimëve bëhet me përparësi nga zyrat e punës e përkujdesjes sociale”.*

c) Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”, propozuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj mase është Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

5. Programi ka për qëllim të mbështesë kategorinë e të rinjve nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë statusin e jetimit, janë të papunë e të pastrehë dhe janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë.

6. Plani i ndihmës parashikon mbështetje të këtij grupi punëkërkuar të papunë, me qëllim lehtësimin e integritetit në jetën shoqërore, ekonomike dhe në tregun e punës, duke u siguruar punësimin e qëndrueshëm të kësaj kategorie.

7. Mbështetja për këtë program do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit, që alokohen çdo vit për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

8. Projektet fituese do të përfitojnë format e mbështetjes nga fondet e nxitjes së punësimit si:

- një financim në masën 10 mijë lekë në muaj për trajnimin nëpërmjet punës, për çdo person, për një periudhë 3-mujore;

- një financim mujor në masën 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore.

9. Punëdhënësit, të cilët përfitojnë nga kjo skemë, janë të detyruar të ofrojnë punësim për punëkërkuar edhe për 6 muaj të tjerë pas përfundimit të mbështetjes me subvencionim.

10. Zbatimi i skemës do të nisë në vitin 2016 dhe ka një afat të përcaktuar kohor prej 5 vitesh.

11. Skema është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

12. Skema zbatohet për të gjithë sektorët e ekonomisë, për punëdhënësit, të cilët nuk duhet të kenë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës, si edhe duhet të kenë derdhur rregullisht tatimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

13. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;

- b) jepet një avantazh ekonomik; dhe

- c) ndikimi në konkurrencë dhe tregti.

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo formë, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara."

Aktivizimi i burimeve shtetërore

Masa e njoftuar mbulon koston e pagës në formën e mbulimit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të pjesës së kontributit të punëdhënësit, si edhe financimin e shpenzimeve të trajnimit të ofruar nga ndërmarrja. Të gjitha këto forma financohen direkt nga buxheti i shtetit, duke aktivizuar fonde shtetërore.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

Masa e njoftuar ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet përfituese dhe i lehtëson nga detyrime financiare, që do të duhet t'i paguanin në kushte normale tregu, duke u dhënë një avantazh ekonomik.

Ndihma ka karakter selektiv, sepse prej saj do të mund të përfitojnë vetëm ato ndërmarrje-/punëdhënësit, që përzgjidhen fitues nga organet e miratimit të projekteve, sipas parashikimeve në projektvendimin e Këshillit të Ministrave. Ndërmarrjet përfituese do të aplikojnë me projekte, të cilat do të shqyrtohen dhe do të miratohen nga organet përgjegjëse nga pikëpamja e dobisë social-ekonomike. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg do të mund të përfitojnë nga kjo masë.

Ndikimi në konkurrencë dhe tregti

Masa e njoftuar ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Sa më lart, masa përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.

IV. Përputhshmëria e ndihmës

14. Komisioni vlerëson se plani i dhënies së ndihmës shtetërore është i përbërë nga dy komponentë a) ndihma shtetërore për trajnim; dhe b) ndihma shtetërore për punësim.

15. Lidhur me ndihmën shtetërore për trajnim, sipas të dhënave nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndihma do të jepet për trajnim të përgjithshëm dhe intensiteti i saj nuk do të kalojë 30% të kostove të trajnimit, duke qenë më i ulët se intensiteti maksimal i lejuar në nenin 12, shkronja “b”, të ligjit, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

16. Lidhur me ndihmën shtetërore për punësim, Komisioni konstaton se masa “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit” jep stimuj për punëdhënësit, me qëllim punësimin e punëkërkuessve të papunë, që u përkasin shtresave vulnerabël, jetim dhe të pastrehë, pjesë e grupeve të veçanta¹ dhe sipas ligjit për ndihmën shtetërore, konsiderohen si punonjës në vështirësi. Intensiteti i ndihmës që përfitojnë ndërmarrjet është në masën 16.7% të kostove të pagave, duke qenë brenda vlerës së lejuar nga ligji për punonjësit në vështirësi (50% të kostove të pagave).

17. Sa më lart, Komisioni konstaton se masa është e kufizuar në kohë, ka efekte pozitive në nxitjen e punësimit për punonjësit në vështirësi dhe efekti në konkurrencë është i vogël.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 10, 11 dhe 17, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit të punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Të gjitha planet të cilat ndryshojnë masën e ndihmës duhet të njoftohen dhe marrin miratimin paraprak të KNSH-së.

3. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, brenda datës 31 mars, të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

¹ Neni 2, pika 20 e ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar.